

Trafikimi i qenieve njerëzore është vepër penale. Viktimat kanë të drejtë për ndihmë!

Kur jeni një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual/prostitucion të detyruar?



Ju keni ardhur në Gjermani për të punuar këtu legalisht. Por në vend të kësaj ju kanë dërguar, kundër vullnetit tuaj, në prostitucion.

- Jeni kercënuar, goditur, izoluar dhe kontrolluar.
- Ju kanë kërcënuar se do t'u bëjnë keq të afërme apo familjes tuaj.
- Jeni detyruar të kryeni akte seksuale.
- Ju kanë marrë pasaportën/ kartën e identitetit/ lejen e qëndrimit/ vizën.
- Ju nuk keni letra të vlefshme për qëndrim, prandaj jeni ilegalisht në Gjermani.
- Ju nuk e flisni gjuhën tonë dhe ndiheni i/e vetmuar këtu.
- Ju kanë thënë se as Policia dhe as Institucionet tjera nuk mund t'ju ndihmojnë.
- Keni frike se do të deportoheni.
- Ju kanë detyruar t'i dorëzoni paratë e fituara, p. sh. për të shlyer borxhet apo për të paguar shpenzimet e udhëtimit.
- Ju kanë penguar t'i jepni fund ushtrimit të prostitucionit.

Cila është ndihma që mund të përfitoni?



- Nëse është e nevojshme do të strehoheni në një vend të sigurtë dhe të mbrojtur.
- Do të mbështeteni për të siguruar jetesën dhe shërbimin mjekësor.
- Do të mbështeteni gjatë kontaktimit të Institucioneve, p. sh. të Zyrës për Migracion, Zyrës Federale për Migracion dhe Refugjatë.
- Ne do t'ju ndihmojmë të kontaktoni Avokatë dhe Avokate dhe do t'ju shoqërojmë gjatë proceseve Gjyqësore.
- Ne do t'ju ndihmojmë të sqaroni çështjen e drejtës së qëndrimit.
- Ne do t'ju ndihmojmë nëse doni të largoheni.

Në qendrat këshilluese fliten gjuhë të ndryshme. Nëse është e nevojshme, do të konsultohet/merret përkthyesi/përkthyesja.

Ndihma jonë është falas dhe konfidenciale.